



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:231511

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05432517

P.nr.1137/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Erzana Hameli- Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1953-4/23 të datës 27.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në seancë publike, në praninë e prokurorit të shtetit Naim Gashi, të dëmtuarit M.W., më datë 14.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

E.R., nga i ati, e ëma, e lindur, i lindur më, në Prizren, ku edhe tani banon në rr “” lam., ka të kryer fakultetin, me profesion tregëtar, i divorcuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, goran, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Nga data 21.07.2020 e deri më datë 18.10.2023, i pandehuri me dashje nuk i binden vendimit të plotfuqishëm të gjykatës – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C.nr.1078/2019 të dt.21.07.2020 i cili është bërë i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AC nr. 6468/20 të dt. 06.04.2021, në atë mënyrë që edhe përkundër faktit sipas këtij Aktgjykimi ku në dispozitivin nën III i njëjti ka qenë i obliguar që në emër të alimentacionit për fëmijët e mitur S. dhe A.R., të paguaj për secilin nga 150.00 – gjithsejtë 300.00 euro çdo muaj, përmes llogarisë rrjedhëse të paditëses – ish bashkëshortes së tij M.W., nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri në ndryshimin e rrethanave.

- Këso dore ka kryer veprën penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38,39, 40, 43, 44 69,70 të KPRK-së dhe nenit 393 par 1 dhe nenit 364 të KRPPK-së nr. 08/L-032 (KPP), të akuzuarin :

GJYKON

Për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të akuzuarit i shqipton **dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat kohor prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim

E dëmtuara M.W., realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest te rregullt juridike- civile.

I akuzuari OBLIGOHET që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II. nr. 1953-4/23 të datës 31.10.2023, ndaj të akuzuarit E.R., nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues me datë 14.02.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim të akuzuarit E.R., pas udhëzimeve të dhëna nga gjykata, konsultimeve, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Naim Gashi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vlerësojmë se aktakuza e Prokurorisë themelore në Prizren PP/II.nr. 1953-4/23 të dt. 31.10.2023 është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të besueshme, përshkrimi faktik si në dispozitiv të kësaj aktakuze, kjo gjendje faktike është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve e i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare pa kurrfarë presioni dhe kjo gjendje faktike e vërtetuar mbështetet në provat e çështjes që i ka aktakuza. Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, faktin se këtu i pandehuri ka paguar alimentacion por këtë e ka bërë në emër dhe në xhirollogarinë të fëmijëve, fakt këtë të cilin e pohoj edhe e dëmtuara këtu se kjo pagesë është bërë në emër të xhirollogarisë të fëmijëve të saj, e po ashtu faktin se i njëjti ka filluar ta zbatoj vendimin e gjykatës duke paguar në llogarinë e të dëmtuarës, si dhe premtimin e të njëjtit se do ta paguaj alimentacionin si dhe do të ia paguaj dy muajt e mbetur dhe atë në xhirollogarinë e ish bashkëshortes së tij, ndërsa si rrethanë rënduese të merr parasysh faktin se i njëjti edhe përkundër faktin që ka qenë i obliguar që alimentacionin ta paguaj në xhirollogarinë e të dëmtuarës ish bashkëshortes së tij i njëjti nuk e ka zbatuar vendimin e gjykatës, andaj i propozoj gjyqtarit gjykues që të i ketë

parasysh rrethanat lehtësuese të cekura më lart dhe të akuzuarit të i shqiptoj një dënim të paraparë me ligj bazuar në këto rrethana e që në rastin konkret mundë të jetë edhe vërejtje gjyqësore.

E dëmtuara M.W., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se se të pandehurin e kam pasur ish bashkëshort, me të njëjtin jemi të divorcuar, kërkoj nga i njëjti që të më mos pengoj në jetën time private as mua e as fëmijëve të mijë, po ashtu kërkoj që vajzat e mija jetojnë me ish bashkëshortin tim të jetojnë të qetë dhe të lumtur dhe në mënyrë normale, kërkoj që ish bashkëshorti im të respektoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 1078/19 të dt. 21.07.2020 i cili është i plotfuqishëm dhe atë kërkoj që i njëjti të paguaj alimentacionin për fëmijën e mijë të mitur A.R.; për një fëmijë dhe atë shumën prej 300 € dhe atë për dy muaj në xhirollogarinë time të cilën shumë veç ish bashkëshorti im ka filluar ta paguaj dhe të njëjtin për mosrespektimin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës që i njëjti nuk e ka respektuar të vendos gjykata duke vepruar sipas ligjit dhe njëherë për këtë çështje dhe i bashkëngjitëm ndjekjes penale ndaj të njëjtit dhe këto që i kërkoja sipas ligjit i njëjti të i përmbush konformë dispozitave ligjore të vendimit të kësaj gjykate me numër të cekur më lartë. Dua të shtoj një fakt se ish bashkëshorti im E ka filluar për herë të parë në xhirollogarinë e vajzave të mija dhe atë për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023, nuk i ka paguar dhe për këto dy muaj kërkoj nga i njëjti që të i paguaj në xhirollogarinë time ndërsa të tjera i ka paguar në xhirollogarinë e vajzave.

I akuzuari E.R., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe dua të shtoj edhe faktin se unë jam munduar që ta respektoj vendimin e kësaj gjykate C.nr. 1078/2019 dhe e pohoj faktin se unë e kam paguar alimentacionin për fëmijët e mitur të mijë dhe atë nga dt. 30.12.2021 dhe atë në llogarinë bankare të vajzave të mija S.R., dhe S.R., e jo në xhirollogarinë e ish bashkëshortes time M.W.; sepse unë nuk e kam poseduar xhirollogarinë e ish bashkëshortes time dhe në momentin kur e kam pranuar xhirollogarinë e ish bashkëshortes time unë kam filluar të paguaj në xhirollogarinë e ish bashkëshortes me dt. 18.08.2023 dhe kjo është arsyeja që unë nuk kam mundur ta respektoj Aktvendimin e gjykatës dhe dua të shtoj edhe një fakt se që nga momenti kur unë jam ndarë nga bashkëshortja ime dhe kur ajo ka dalur nga banesa ime unë asnjëherë nuk e kam penguar në jetën e saj private dhe as që do ta pengoj dhe premtoj që unë do ta përmbushi obligimin lidhur me alimentacionin e fëmijëve të mijë duke e respektuar vendimin e gjykatës ngase edhe kam obligim prindër që të kujdesem dhe po ashtu edhe për ato dy muaj që kanë mbetur do të i përmbushi.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 322 lidhur me 241 të KPPRK-së. Me rastin e pranimit të fajësisë, gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi ka mbështetje në faktet dhe provat materiale që gjendjen në shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPPRK-së, për pushimin e procedurës penale, përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 322 lidhur me nenin 241 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës ka vërtetuar se Nga data 21.07.2020 e deri më datë 18.10.2023, i pandehuri me dashje nuk i binden vendimit të plotfuqishëm të gjykatës – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C.nr.1078/2019 të dt.21.07.2020 i cili është bërë i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AC nr. 6468/20 të dt. 06.04.2021, në atë mënyrë që edhe përkundër faktit sipas këtij Aktgjykimi ku në dispozitivin nën III i njëjti ka qenë i obliguar që në emër të alimentacionit për fëmijët e mitur S. Dhe A:R., të paguaj për secilin nga 150.00 – gjithsejtë 300.00 euro çdo muaj, përmes llogarisë rrjedhëse të paditëses – ish bashkëshortes së tij M.W., , nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri në ndryshimin e rrethanave.

Andaj, kjo gjykatë duke u bazuar në ato që u thanë më lartë, ka vërtetuar gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par 1 të KPRK-së. Me këtë rast, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro të cilën shumë i akuzuari obligohet të paguaj në afat kohor prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata ka vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, premtimin e përmbushjes së obligimit për dhënien e alimentacionit si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë natyrën, llojin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla të kundërligjshme dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari. Në fund, gjykata ka marrë parasysh edhe sanksionet tjera penale të përcaktuara me KPRK, mirëpo ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, në mënyrë të plotë dhe të drejtë mund të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2023:231511, 14.02.2024

B. Profesional
Erzana Hameli- Mustafa

Gjyqtari
Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore